STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 10 maj 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) VENDOS EKIPET E NDIHMES PER SENDIN (SANDY) NE QARKUN ROKLEND (ROCKLAND)

Personeli i trainuar do të ndihmojë viktimat e Sendit (Sandy) me kërkesat për ndihmën federale të strehimit dhe të rimëkëmbjes së biznesit

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) është duke vendosur përfaqësues të Ekipit të Ndimës për Sendin (Sandy) në vendndodhje në Qarqun Roklënd (Rockland) të hënën 13 maj dhe të martën 14 maj për të ndihmuar që pronarët e shtëpive dhe pronarët e bizneseve të prekura nga super stuhia Sendi (Sandy) të bëjnë kërkesa për ndihmë të rimëkëmbjes.

Personeli i trainuar, si nga Shteti, ashtu edhe nga Qarku Roklënd (Rockland) do të jetë në dispozicion për t'u takuar me banorët në këto vendndodhje të hënën 13 maj dhe të martën 14 maj:

Stoni Point (Stony Point)
Rho Building
5 Clubhouse Drive
Stoni Point (Stony Point), NY 10980
11:00 paradite deri në 6:00 pasdite

Piermont
Village Hall
478 Piermont Avenue
Piermont, NY 10968
11:00 paradite deri në 6:00 pasdite

Anëtarja e Kongresit Nita Loui (Nita Lowey), "Ndërsa shumë pronarë të shtëpive dhe biznese të Qarkut Roklënd (Rockland) rimëkëmben dhe rindërtojnë pas super stuhisë Sendi (Sandy), është një lajm i mirë që këta përfaqësues të Ekipit të Ndihmës për Sendin (Sandy) do të jenë në dispozicion për të ndihmuar banorët që të bëjnë kërkesa për ndihmën shumë të nevojshme nga stuhia. Ndihma federale pas Sendit (Sandy) ka qënë vendimtare për të ndihmuar që banorët në Luginën e Poshtme të Hadsonit (Lower Hudson Valley) të rimëkëmben dhe jam e gëzuar që banorët e Roklëndit (Rockland) do të kenë mundësinë e përdorimit të këtyre burimeve të rëndësishme."

Zyrtari i Qarkut C. Skot Vanderhof (C. Scott Vanderhoef) tha, “Jam i gëzuar që Ekipi i Ndihmës për Sendin do të vizitojë Fshatin e Piermontit (Piermont) dhe Qytezën e Stoni Point (Stoni Point). Prania e tyre sigurisht do t’u shtohet përpjekjeve të jashtëzakonshme të agjencive tona, veçanërisht Zyrës së Shërbimeve të Zjarrfikësave dhe të Urgjencës (Office of Fire and Emergency Services) dhe Zyrës së Zhvillimit të Komunitetit (Community Development Office), në vazhdimin e hartimit të strategjive për të ndihmuar që bizneset dhe pronarët tanë të shtëpive të rimëkëmben dhe të rindërtojnë nga super stuhia Sendi (Sandy).”

Për të bërë kërkesë për ndihmë të rimëkëmbjes së strehimit ose biznesit, vizitoni http://nysandyhelp.ny.gov/.

Ndihma për rimëkëmbjen e biznesit është gjithashtu e disponueshme në vendodhjet e Qendrës për Rimëkëmbjen nga Katastrofa dhe për Zhvillimin e Bizneseve të Vogla të NYS (NYS Small Business Development Center Disaster Recovery) në Qarkun Roklënd (Rockland):

Safërn (Suffern)
Rockland Community College
145 College Road
Safërn (Suffern), Nju Jork (New York) 10901
845-356-6065
Të hënën deri të premten 9:00 paradite deri në 5:00 pasdite
Të shtunën 9:00 paradite deri në 5:00 pasdite

Havërstro (Haverstraw)
37 West Broad Street, 2nd Floor
Havërstro (Haverstraw), Nju Jork (New York) 10927
845-356-6065
Të hënën deri të premten 9:00 paradite deri në 5:00 pasdite

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418